



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2264/Prot.
139

Tiranë, më 14.10.2024

VENDIM

Nr. 25, datë 14.10.2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR SHQYRTIMIN
DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË
HAPUR ME OBJEKT: “MBI DHËNIEN E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN
E FREKUENCAVE 3400 - 3800 MHZ (3.5 GHZ)”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira Dvorani	Anëtar
3. Z. Armer Juka	Anëtar
4. Z. Bleron Dokle	Anëtar
5. Z. Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 14.10.2024, konform procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues, Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe VKM nr.1252, datë 10.9.2008, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënie e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- **Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit publik me objekt “Mbi dhënie e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400 - 3800 MHz (3.5 GHz)”.**

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 6, 7, 8, 68 dhe 69 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

3. Kreu III, pikat 14.1 dhe 17.1 të VKM nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar.
4. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (PKF).
5. VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit”.
6. Plani i Përdorimit të Frekuencave (PPF), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7 datë 06.09.2023.
7. Rregullore e brendshme e Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP, e ndryshuar.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Relacioni përkatës;
- Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar.

VËREN SE:

AKEP referuar detyrimit dhe afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon procedurat e konkurrimit publik për dhënie e autorizimeve individuale për një numër të kufizuar për përdorimin e frekuencave, me Vendim të KD-së nr. 20, datë 27.8.2024, ka miratuar Dokumentin e Tenderit publik “Procedurë e hapur”, me objekt: “Mbi dhënie e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400 - 3800 MHz (3.5 GHz)”, i cili gjendet i publikuar në faqen web të AKEP www.akep.al. Ky tender do të zhvillohet në ambientet e AKEP në datën 17.10.2024, ora 10:00.

Në Kreun III, pikat 14.1 dhe 17.1 të VKM nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar, përcaktohet se, “Për hapjen dhe shqyrtimin e ofertave, AKEP ngre Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), përbërja, të drejtat dhe detyrat e të cilit përcaktohen në këtë vendim”. Komisioni i vlerësimit të ofertave - KVO caktohet nga AKEP dhe përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) persona, specialistë të fushës përkatëse të AKEP, përfaqësues të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Me shkresën nr. 2264/33 prot., datë 16.9.2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka njoftuar AKEP për caktimin e përfaqësuesit të saj në KVO-në që do të ngrihet në AKEP.

Me shkresën nr. 2264/34 prot., datë 16.9.2024, Ministria e Financave, ka njoftuar AKEP për caktimin e përfaqësuesit të saj në KVO-në që do të ngrihet në AKEP.

Me shkresën nr. nr. 2264/38, datë 03.10.2024, Ministria e Drejtësisë, ka njoftuar AKEP për caktimin e përfaqësuesit të saj në KVO-në që do të ngrihet në AKEP.

Dokumentacioni për ngritjen e KVO për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të tenderit publik me objekt “Mbi dhënie e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400 - 3800 MHz (3.5 GHz)”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, të ndryshuar;

VENDOS:

1. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), të ketë në përbërje:

- 4 (katër) përfaqësues nga AKEP;
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Financave;
- 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

2. Përfaqësues nga AKEP në KVO, të jenë:

- | | | |
|-------------------|-----------------|---------|
| - Z. Vasil Mitezi | Drejtor i DMKI | Kryetar |
| - Z. Bledar Kazia | Drejtor i DT | Anëtar |
| - Z. Gazmir Mani | Drejtor i DTMRR | Anëtar |
| - Z. Klevis Limaj | Përgjegjës DJI | Anëtar |

3. Referuar kthim përgjigjes së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, administruar në AKEP me nr. 2264/33, datë 16.9.2024, përfaqësues në KVO do të jetë:

- Z. Fotjon Kosta, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave – Anëtar.

4. Referuar kthim përgjigjes së Ministrisë së Financave, administruar në AKEP me nr. 2264/34, datë 16.9.2024, përfaqësues në KVO do të jetë:

- Z. Gentian Opre, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit - Anëtar

5. Referuar kthim përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë, administruar në AKEP me nr. 2264/38, datë 03.10.2024, përfaqësues në KVO do të jetë:

- Z. Edmond Muçaj, Inxhinier Mekanik - Anëtar

6. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e KVO-së përcaktohen në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe specifikisht në VKM nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Lorenc Bako

Bleron Dokle

Armer Juka